

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“TRAKTOR DHE ARGANELLË”**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Traktorë – 16700000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT : **5 833 000** (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë) **Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Do të plotesohen me plotesimin e kapacitetit të përgjithshëm.

1.1 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve, 2021, 2022 të vërtetuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrushëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të

ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore lëshuar nga Administrata Tatimore të viteve , 2021 dhe 2022, ku vlera të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

3. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin një vërtetim të lëshuar nga administrata e qeverisjes vendore, që konfirmon shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, përfshirë edhe këstin e maturuar të vitit 2023, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore. (kjo pikë plotësohet me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas parashikimeve ligjore.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e TaksaveVendore" indryshuar, ne

ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” indryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” indryshuar, sidhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se **10%** e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Operatori Ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë kontratën e lidhur si dhe vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore e shitjes,të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqiku shënohet data,shuma dhe shërbimet e realizuar.
ose
- Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik do ta vërtetoje këtë duke paraqitur,kontratë furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shenohen data, shumata dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Shenim: Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor,përpara publikimeve të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,të gjithë dokumentacionin promovues për vetëdeklarimet në formatin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Në të gjitha rastet kur përdoret emer ose marka ,njihet njëvlefshmëria apo barazvlefshmëria,ose ekuivalenti.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.